

---

**Arnavutça Özetler**  
*Albanian Summeries / Përmbajtiet Në Shqip*

---



## ARNAVUTÇA ÖZETLEMELER

### ALBANIAN SUMMARIES

### PËRMBAJTIET NË SHQIP

**Anila SHEHU POLAT<sup>1</sup>**

Alevilik-Bektaşilik Araştırmaları Dergisi bu sayısında yer alan makale ve araştırma yazılarının Arnavut okuyucular için kısa bir özetlemesini yaparak, onların da dergimizin içeriği ile ilgili az da olsa bir bilgiye sahip olmasını, gerektiğinde geniş çeviriler yapmalarına zemin hazırlamak istedik.

Për lexuesit shqipfolës të Revistës Studimore Alevizmi-Bektashizmi kemi përgatitur nga një përmbajtje të shkurtër në Shqip për të gjitha shkrimet dhe studimet e përfshira në këtë numër, sepse mendojmë që në këtë mënyrë mund të krijojnë një ide sado të vogël përreth përmbajtjes së kësaj reviste dhe kështu duam të krijojmë dhe ti hapim rrugë mundësisë që në rastet e nevojshme të bëhen më shumë përkthime

---

<sup>1</sup> Aydın Üniversitesi, Didim meslek Yüksekokulu Okutmanı



## NEVI<sup>2</sup> DHE TERKIB-I BENDET<sup>3</sup> QË I SHKRUAJTI PËR EHL-I BEJTIN

Doç. Dr. Süleyman SOLMAZ

### Përmbledhje:

Feja është një nga elementët më të rëndësishëm të kulturës e cila i ndikon mbi elementet e tjera që nga koka deri tek këmbët. Ky cikël ndikimi nuk ka ngelur vetëm në rregullat fetare por ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në disa ngjarje fetare.

Grupi i përbërë nga Fatma bija e Profet Hz. Muhammed, dhëndri i tij Hz. Ali si dhe nipërit Hz. Hasan dhe Hysejin quhet âl-i abâ. Ky grup ka edhe një emër tjetër që është ehl-i bejt. Ky koncept ka kuptimin e shtëpisë ose anëtarët e familjes dhe zë një vend shumë të rëndësishëm në Islam e veçanërisht në Bektashizëm, Alevizëm dhe Mevlëvizëm si edhe në shumë tarikate e sekte modeste Islame. Hz. Aliu posedon një vend shumë të rëndësishëm në historinë Islame. Edhe bijtë e tij Hz. Hasan dhe Hysejni janë bërë shumë herë subjekt i kulturës dhe letërsisë sonë. Ehl-i Bejt; ka frymësuar shumë poet të cilësuar si bende-i âl-i abâ (skllavi i banorëve të shtëpisë) për shumë poezi të tyre. Veçanërisht biri i Hz. Hysejnit dhe Zejnel-abidin (Zeyne'l-âbidin) që është hallka e katërt e silsinesë, zënë një vend shumë të rëndësishëm brenda dymbëdhjetë imamëve prandaj dhe shumë shpesh hasim në to edhe në veprat letrare. Në këtë studim janë marrë në dorë poezitë që kanë në përmbajtje temën e dymbëdhjetë imamëve dhe anëtarësia e tyre, të shkruara nga poeti i letërsisë divan (një lloj letërsie vjershash e përdorur në Orient) Nevi nga Mallkara (Malkaralı Nev'î) që jetoi në shekullin e 16-të. Qëllimi i këtij studimi është hulumtimi se si është pasqyruar në letërsi dashuria për Ehl-i Bejtin duke përdorur si shembull poetin Nevi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Në studimin tonë në fillim do të jepen disa të dhëna të përgjithshme për dymbëdhjetë imamët. Më pas do meren në dorë një e nga një bejtet e shkruara nga Nevi në mënyrën terkib-i bend dhe do të shkruhen në Turqishten e sotme. Gjatë kësaj pune do të shkruhen shpjegime aty ku mendohet se është e nevojshme.

**Fjalët Kyçe:** Dymbëdhjetë imamët, Misticizëm, Alevi-Bektashi, Islam, Poezia Klasike Osmane (Poezia e Divanit), Terkib-i bend

<sup>2</sup> Emri i një poeti të shquar e letërsisë Osmane



## KRITSHTËRIMI NË PERIUdhËN MESJETARE DHE NDIKIMI I SAJ MBI FILOZOFINË E FEVE ISLAME SI DHE MBI SHKENCAT

Sibel KÛÇÛK

### Përmbledhje

Problemi i marrëdhënieve mes fesë dhe shkencës e ka shqetësuar mendjen e njeriut që në kohët e lashta, mbi të gjitha ky problem asnjëherë nuk është zgjidhur plotësisht e as nuk është harruar plotësisht. Aktivitete e mendjes së njeriut janë faktori kryesor që kanë mundësuar lindjen e filozofisë. Megjithëse fizolofia, feja dhe shkenca janë disiplina të ndryshme, po ti shohësh nga pikëpamja e cikleve historike vihet re që herë janë afruar e herë janë larguar nga njëra tjetra. Në periudhën antike shkenca dhe filozofia kanë qenë larg ndikimit fetar, kurse në mesjetë shkenca pati ngelur nën ndikimin e fesë madje ka sipërmarrë krijimin e themeleve të besimit fetar. Në përnëdim në kohën e mesjetës u shfaqën shkollat filozofike të Patristikës dhe Skolastikës të cilat si pasojë e ndikimit fetar nuk patën shumë epërsi. Po në të njëjtën periudhë, në botën Islame të mesjetës shkenca dhe filozofia filloi të zhvillohet nën themelet e fesë. Rikomentimi i llogjikës së Aristotelit nga ana e filozofëve Islam dhe zhvillimin e tyre bëri të mundur shpejtimin e zhvillimit të filozofisë dhe shkencës.

Është mëse e qartë se në mesjetë shkenca dhe filozofia ka ngelur nën ndikim të feve por ajo që bën dallimin mes botës Islame dhe asaj të Krishterë është që ndikimi i Krishtërimit e la shkencën dhe filozofinë të prapambetur. Kurse bota Islame me mënyrën e të menduarit që e nxorrën në pah duke përdorur llogjikën e Aristotelit ndikuan edhe vetë botën e Krishterë. Është i pa diskutueshëm që me anë të përkthimeve të vepërave Antike Helene si dhe komentet e zgjuara që bënin patën një ndikim në filozofët e Krishterë. Ky ndikim ishte aq i theksuar sa që filozofët e shquar të asaj kohe kanë shkruar qortime dhe rrefuzime ndaj filozofisë Islame.

Është i padiskutueshëm ndikimi i fesë në filozofi. Në mesjetë për temat dhe gjendjen e filozovisë kishte ndryshime mes botës Islame dhe asaj të Krishterë, kur bota Islame po jetonte një periudhë shumë të shkëlqyer për shkencën dhe filozofinë bota e krishterë ishte në një errësirë shumë të egër. Nuk mund të lihet pas dore ndikimi që pati kjo periudhë e shkëlqyer e filozofëve Islam për krijimin e perëndimit modern të sotëm.

**Fjalët Kyçe:** Mesjeta, Filozofia e mesjetës, Skolastike, Krishtërimit, Islami.





## DISA SHËNIME MBI ALEVIT E HATAJIT (NUSAYRILERI)<sup>4</sup>

(1938-1950)

Yrd. Doç. Dr. Şemsettin ÇELİK<sup>5</sup>

### Përmbledhje

Me Marrëveshjen e Ankarasë më 1921 Franca, e shkëputi Hatajin nga atdheu i tij prandaj dhe në 1936-tën u kërkua që të bashkohen me Sirinë. Turqia, duke dashur që ta pengojë këtë, në kohën kur ishte nën kontrollin e Francës si dhe nën dikimin e propogandës të Arabizimit, Alevitë që jetonin në rajon tashmë të larguar nga kultura turke u përpoqën ti rifitonin. Prandaj dhe për këtë qëllim si para bashkimit ashtu edhe pas bashkimit për rajonin në fjalë janë përpiluar politika shoqërore, kulturore, ekonomike dhe arsimore. Këto politika u përqëndruan më shumë mbi Alevitë sepse ata kishin një epërsi mbi popullsitë e tjera nga pikëpamja e numrit të popullsisë. Politikat e përdorura dhanë fryte prandaj dhe në atë kohë pjesa më e madhe e Alevive në Hataj vendosën të qëndrojnë në Turqi kurse një pjesë e vogël u detyrua të largohen nga Hataji. Por më vonë aty nga fundi i viteve 1940' u një pjesë e të larguarve u rikthyen në Turqi. Nga ana tjetër në këtë periudhë nga Alevitë e Hatajit dolën në pah figura të shquara të politikës në rajon siç ishin; Ali Şelhum (Shelhum) Devrim, Zeynelabidin Cilli (Zejnelabidin Xhil-li) dhe Abdullah Cilli. Një nga pikat kryesore të politikave ndaj Alevive të Hatajit ishte hapja e kurseve për të mësuar Turqisht. Për këtë arsye Shtëtpitë Polullore dhe Dhomat Popullore të cilat ishin një zgjidhje të CHP-së (Partia Popullore Republikane) kishin shumë punë për të bërë. Veçanërisht në “shtëtpitë polullore” dhe “dhomat popullore” që ndodheshin në rajonet e banuar nga Alevitë Turq u hapën kurse dhe shkolla për gjuhën Turke. Për të vendosur më mirë kulturën turke u organizuan aktivitete sportive dhe konferenca. Megjithë politikat e ndjekura, deri në fundin e viteve 1940 nuk u arrit që të zgjidhej plotësisht problemi i gjuhës që përdornin alevitë e Hatajit, madje kjo gjendje në fillim të vitit 1949 u pasqyrua edhe në rreshtat e medias lokale. Kjo temë erdhi në atë gjendje sa u diskutua nga intelektualët e zonës madje edhe popullsia vendase filloi të shqetësohej nga kjo gjendje. Nga ana tjetër në këtë periudhë brenda dhe jashtë shtetit filloji të zhvillohej një propagandë tjetër negative ndaj Alevive të Hatajit. Por kjo propogandë u netraulizua në sajë të

4 Terkib-I Bend një lloj poezie

5 Hataj (Hatay) është një rreth i Turqisë në kufi me Sirinë dhe popullsia aleviane me prejardhje Arabe shpesh quhen Nusayriler (Nusajrilerët)

masave të marra nga shteti si edhe në sajë të qëndrimit të matur që mbajtën Alevitë e Hatajit. Shkurtimisht në këtë studim jemi përpjekur të japim të dhëna për Alevitë e Hatajit duke u bazuar në Arshivin e Kryeministrit të Republikës që u përkasin viteve 1938-1950 si edhe dokumente lokale që i përkasin periudhës së lartpërmendur; është përqëndruar në aktivitetet socio-kulturore dhe edukative e bëra për alevitë në periudhën e bashkimit si edhe më pas; u mundua të vihet në pah qëndrimi që kanë mbajtur Alevitë e Hatajin ndaj këtyre propagandave që janë bërë ndaj tyre.

**Fjalët Kyçe:** Alevitë e Hatajit, Bashkim, Edukim, Shtëpitë Popullore, Turqisht, Dhomat Popullore.

**BEKTASHIZMI NGA E SHKUARA DERI NË DITËT TONA***H. Dursun Gümüšoğlu<sup>6</sup>***Përmbeldhje:**

Dihet që në epokën e parë të Drejtimit Osman, veçanërisht Bektashizmit i është dhënë shumë rëndësi, kurse pas shekullit të 16-të në një mënyrë graduale filloi të paragjykohej, biles u mbajt një qëndrim armiqësor. Në këtë studim do të merren në dorë fazat që kaluan Teqetë Bektashiane, problemet që patën, marrëdhëniet e Baballarëve Bektashi me Çelebijtë, preceptimi i besimit, përbërja sociale, gjendia e Bektashizmit në ditët e sotme, erozionet kulturore që pësuan dhe do të ketë një vlerësim se si do të vazhdojë të jetë Bektashizmi duke e parë nga pikëpamja e të ardhmes.

**Fjalët Kyçe:** Çelebitë, Babalarët Bektashi, Teqetë Bektashiane

---

<sup>6</sup> Instruktor në Universitetin Bayburt Üniversitesi, Fakulteti i Edukimit “Bayburt”, Arsimi Fillor – Historia e Republikës së Turqisë.



## PIRI I LUMIT: BABA KOYUN<sup>7</sup> DHE JETA E TIJ

**Prof. Dr. Ahmet Taşğın<sup>8</sup>**

### Përmbledhje

Në këtë studim është marrë në dorë udhëtimi i Baba Koyun-it (Kojunit) që fillon nga Horosani dhe u përqëndrua në dy vendqëndrime kryesore, në Bursa dhe rrotull lumit Kızılırmak (Këzëllërmak) si edhe aktivitetet që ai ka bërë në këto zona. Këto tituj janë përcaktuar sipas dorëshkrimit nr. 06 Mil Yz A 2864/2 që gjendet në Bibliotekën Kombëtare në të cilën flitet mbi jetën e Baba Kojunit. Sipas shkrimeve të jetës së tij Baba Kojunu e mori emrin nga zgjuarsia dhe bëmat e tij. Ai, në disa vende njihej si çoban dhe në disa vende si kujdestar emrin e vërtetë e ka Seyti (Sejti) Ali. Përveç kësaj në disa dorëshkrime të tjera flitet për dy emira të veçantë si Baba Kojun dhe Seyit Ali e mes marrëdhënjeve të këtyre dy emrave ka ngjasimet dhe ndryshime nga njëri tjetri. Përveç kësaj i është dhënë vend edhe litareturës dhe studimeve të tjera që kanë marrë në dorë jetën dhe veprën e Baba Kojunit.

Në këtë studim është marrë në dorë tema e “Jetës dhe Bëmave të Baba Kojunit” sipas një shkrimi që gjendej në një revistë në Bibliotekën Kombëtare, si edhe komentet e bëra për ngjarjet dhe personat e këtyre ngjarjeve. Veprat e Baba Kojunit gjenden në kopje të shkruara në formën e poezisë dhe prozës si rjedhje u morën në dorë të dyja këto kopje. Në këtë mënyrë u bashkuan të dhënat e dhëna në shkrimet në proze dhe ato të dhëna në formë poezie dhe kështu përpilua dhe japim të dije për aktivitetet e Baba Kojunit, udhëtimet, mësuesit, klerikët me të cilët ai kishte lidhje, takimet e tij me personalitete të shtetit dhe mrekullitë e tij. Përveç këture duke marrë parasysh edhe personat e tjerë që hasim në jetën dhe aktivitetin e Baba Kojunit si dhe duke patur parasysh edhe studimet e tjera u përpoqëm që të bëjmë një pasqyrim më të gjërë dhe me më shumë shpjegime.

Sipas të të dhënave për Baba Kojunin ai, erdhi nga Horosani në Rumi. Nga Rumia kaloi në Menemen në Bursa më pas erdhi dhe u vendos në Osmancık (Osmanxhëk)

<sup>7</sup> Studjues dhe shkrimtar, Göztepe, Stamboll

<sup>8</sup> Koyun lexohet kojun dhe do të thotë dele.

ku dhe u mor me aktivitetet e tij. Baba Kojuni doli në plan të parë më shumë me përpjekjet dhe mendimet që dha për bërjen e një urë mbi lumin Kızılırmak (Këzëllërmak) në pjesën afër Osmanxhëkut. Kjo tregon që mes emigruesve Turq në dy anët e lumit Këzëllërmak ka patur marrëdhënie politike, kulturore dhe pikëpajje fetare por që me kalimin e kohës janë larguar dhe ndryshuar duke bërë që të ftohen marrëdhëniet mes tyre duke çuar në përçarjen e popullit, e kjo dukuri nuk po ndalohej dot. Prandaj dhe Baba Kojuni duke e tërhequr vëmendjen tek kufiri që krijonte lumi Këzëllërmak i dha mendimin Sultan Fatih-ut që të ndërtohej një urë me qëllimin e krijimit të lidhjeve mes popullsisë të dy brigjeve.

Ky shkrim është bazuar mbi hipotezën që jeta e Baba Kojunit, është treguar me plot simbole e sinonime e metafora sipas mëndësisë kulturës dhe botëkuptimit të asaj periudhe. Ura si një simbol, në popujt nomadë ka kuptimin që bën lidhjen mes bashkësive dhe mundëson pakësimin e tjetërsimit dhe ndryshimit që është krijuar. Në një kuptim paralel edhe simbolet si Bari, Dele, Qingj, Qen dhe Kullotë. Emri i Deles (Koyun) përdoret si një simbol që vë në lëvizje të gjitha këto si Bari, Dash, Qingj, Qen dhe Kullotë, ky emër gjithashtu të kujton Kullotat dhe Bjeshkët duke e i bashkuar të gjitha këto në një. Disa herë Baba Kojuni u shndrua në Baba Çobani (Bariu) që drejtonte veten e tij. Gjithashtu u fol edhe për dashin Ali Koçi (Dashi) që në Ballkan njihet me Qentë me emra Ala, Sarë dhe Kara Kadi, si edhe me Qingjat që lindin banjakë dhe me kërkuesit e tyre.

Si përfundim Baba Kojuni doli në plan të parë me udhëtimin që e filloi nga Horosani në Bursa e me radhë në Menemen, përgjatë lumit Këzëllërmak dhe nga Porti i Sinopit kaloni në Rumani, Maqedoni. Ai doli në plan të parë edhe me aktivitetet që kreu në këto vende. Kësaj i shtohen edhe aktivitetet që ka kryer në Menemen, Bergama, gjatë rrugës për Tire, si edhe rreth Kırklareli (Kërklareli), Tekirdağa dhe Edirne-s, ai ishte udhëhetësi i Dyzet Prijësve që morën pjesë në Marrjen e Glibolu-së. Një nga shenjat e këtyre aktiviteteve janë teqetë me emrin Baba Kojuni në vendet që janë përmendur më sipër. Pra duke filluar nga Bursa, Menemen, Kütahya (Kytahja), Lumi Këzëllërmak, Trakya (Trakja) dhe në Ballkan si edhe në shumë vende të tjera ka ambjente që simbolizojnë Shkollat e Baba Kojunit.

**Fjalët Kyçe:** Baba Kojuni, Jeta dhe vepra, Bursa Menemen, Domaniç. Kızılırmak, Osmancık, Sinop, Babadağ, Kalkandelen.

## VENDQËNDRIMI I SARI SALTUKUT NË FSHATIN BAHÇE TË QYTEZËS KOYUHİSAR TË RRETHIT SİVAS

**Abdulkerim Dinç**

### **Përmbledhje:**

Çdo ditë e më shumë po rritet numri i vendeve dhe varreve të Sari Saltukut, kjo tregon se sa prirës i rëndësishëm ka qenë ai. Duke filluar nga Anadulli dhe Ballkani në shumë vende janë gjendur varre dhe teqe në emrin e tij dhe një i ri që është zbuluar së fundmi është ajo e gjetur në fshatin Bahçe pranë qytezës Koyunhisar (Kojunhisar) në rrethin e Sivasis.

Këtij vari i japin shumë rëndësi jo vetëm banorët e fshatit Bahçe por edhe të gjithë banorët rreth e rrotull dhe është një nga vendet që vizitohet shumë shpesh, e vihet re që në javën e dytë të muajit Gusht ka më shumë vizitorë. Për këtë qendër bëhen kurbanë dhe disa aktivitete të veçanta dhe popullsia vendase tregon shumë histori për këtë vend. Ky varr i Sari Saltukut ndodhet në anën e majtë të Luginës Kelkit në Jug-Perëndim të Fshatit Bahçe dhe vetëm 9 km larg tij. Për të shkuar atje kalohet nga një fshat i vogël i quajtur Üç Merék (yç merék) dhe nga bjeshka Delmece emri i kodrës nga fshatarët njihet si “Korda e Sari Saltukut”. Fshatarët thonë që rreth vendit gjenden themele që i përkasin një ndërtese të vjetër. Sipas besimit të popullsisë vendase Sari Saltuku është një nga erenët që u dërgua nga Horosani nga ana e Ahmed Jesevi për të kthyer në myslimanë popullsinë e Anadollit dhe Ballkanit. Sipas besimit të tyre ai ka luftuar këtu bashkë me ushtarët dhe ka rënë dëshmor. Afër këtij vendi gjenden dhe vendet e Baba Sulltanit dhe Baba Edremit. Fshatarët për Sari Saltukun thonë: “Për neve siç janë Pir Sultan, i nderuari Haxhi Bektash Veliu dhe erenët e tjerë përpara tyre vjen Sari Saltuku... Prandaj ne këto vizita do ti bëjmë vazhdimisht.” Ato që tregohen për vendin e Sari Saltukut në fshatin Bahçe të Qytezës Koyunhisar në rrethin Sivas janë mjaft interesante.

\*\* Universiteti Necmettin Erbakan, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Humane, Dega e Sociologjisë, [ahmetyt@hotmail.com](mailto:ahmetyt@hotmail.com), Konya

